



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KURBIN  
KESHILLI BASHKIAK**

Nr. 2056/prot.

Laç, më 24.04.2023

**VENDIM**

Nr. 27, datë 24/04.2023

**“PËR MIRATIMIN E OBJEKTIT “RRUGE KALIMI, PER KALIMIN E  
AUTOMJETEVE , FSHATI DROJE,FUSHE MAMURRAS, N.J.A. MAMURRAS,  
KURBIN”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit 107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” i ndryshuar, ligjin 97/80 datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar,, në Ligjin 57/2020 “Për Pyjet”, VKM nr.433 dt. 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive” i ndryshuar, urdhërin e kryetares së Bashkisë Kurbin, për miratimin e aksesit rrugor për krijimin e një aksesit rruge lidhje, jashte qendrave te banuara me Rrugën e fshatit Droje e cila vjen si nevojë e krijimit te nje rruge lidhese me fshatin Droje dhe gjithashtu rruge ndermjetese e zonës pyjore e cila sherben si rruge sekondare ne rast bllokimi te rrugeve te tjera dhe akses me i shpejte. gjithashtu kjo rrugë do shërbeje si rrugë lidhëse në raste emergjencash si fikja e zjarreve dhe cdo sherbim tjetër i zonave te gjelberta.Pas propozimit nga D.P.K.ZH.T,Agjencia e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave dhe Kryetari i Bashkisë Kurbin,Këshilli Bashkiak;

**VENDOSI;**

1. Miratimin e aksesit rrugor per kalimin e automjeteve, rruge lidhje, jashte qendrave te banuara me Rrugën e fshatit Droje, që lidh rrugën ekzistuese të Drojës me rrugën Kodër Thumanë, në ZK.3412, parcela pyjore 115/a pjesë e E.P.Krastë Krujë, në fshatin Shperdhet të Njësisë Administrative Mamurras , Bashkia Kurbin.
2. Rruga do të këto përmasa:
  - Gjatësi 770ml;
  - Gjërësi mesatare 7 m.
3. Plani i vendosje së gjurmës së rruges në Sh.1: si dhe “Raport mbi studimin tekniko-ekonomik të sipërfaqes pyjore/kullosore në pronësi të bashkisë Kurbin, në fshatin Shpërdhet, njësia administrative Mamurras, mbi të cilën propozohet të ndërtohet rruge auto sipas hartes bashkelidhur.
4. Te pershtatet i gjithë aksi i plote per kalimin e automjeteve.
5. Te kryhen punimet e nevojshme per kthimin e ketij aksi ne gjendje optimale.

6. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Kurbin të marrë të gjitha masat për inspektimin dhe mbështetjen e kryerjes së punimeve.
7. Policia Bashkiake, Agjencia e Infrastrukturës Rrugore dhe Shërbimeve Mbështetëse të Bashkisë Kurbin të ndjekin problematikat dhe mbarëvajtjen ditore të këtij aksesi.

Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetaria e Bashkisë.

>Prefektit Të Qarkut Lezhë

> D.P.K.ZH.T,

>Agjencia e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave

>Arkivi

**SEKRETARI I KESHILLIT**

**Arber LEKA**



**KRYETARË E KESHILLIT**

**Edlira LLESHI**

